



KONFERENCA
Diaspora Flet

POLITIKAT EKONOMIKE
PËR INVESTIM TË DIASPORËS



PROMOVIMI I POLITIKAVE EKONOMIKE DHE INVESTIMET E DIASPORËS

17-20 MAJ 2018

Projekt Propozim:

Hapja e Zyrave për Investime dhe Tregti në kryeqendrat botërore

VIZIONI

Vizioni ynë është që përmes këtyre zyrave të nxisim edhe më shumë ardhjen e investitorëve tone shqiptarë dhe investitorëve të tjerë ndërkombëtar dhe njëkohësisht rritjen e eksporteve drejt këtyre vendeve.

OBJEKTIVAT

1. Krijimi i zyrave ndërlidhëse në kryeqendrat botërore në vendet ku ka më së shumti shqiptar dhe që kanë rëndësi strategjike ekonomike për vendet shqiptare siq janë: Berlina, Frankfurti, Londra, NEW YORKU, Cyrihu, Milano, Vjena, Brukseli, etj.
2. Ofrimi i të gjitha informacioneve në nivel shtetëror lidhur me mundësitë e investimeve në vendet shqiptare dhe potencialet e eksporteve të vendeve tona me shtetet ku themelojmë këto zyre.
3. Promovimi i ekonomive shqiptare në tregje ndërkombëtare duke qenë shumë afër tyre dhe zhvillimi i projekteve ekonomike në raport me interesat e ekonomive tona.

HAPAT PËR REALIZIM TE PROJEKTIT:

1. Koordinimi mes dy qeverive shqiptare për themelim të zyrave të përbashkëta qoftë edhe në kuadër të zyrave të Ambasadave ku janë tani.
2. Gjetja e kuadrove dhe trajnimin i tyre nga kompani dhe institucione këshillueseve nga fusha e investimeve dhe tregtisë ndërkombëtare
3. Fillimi i punës në paktën me një qendër deri në fillim të vitit 2019 dhe krijimi I strategjisë për njoftim të bizneseve dhe institucioneve të rëndësishme për hapje të zyrës si një derë komunikimi për bashkëpunim mes dy vendeve.

HISTORIKU I ORGANIZIMIT TE AKTIVITETIT TONË:

Qeveritë tona kanë dëshmuar se janë më pak se partner të besueshëm gjatë viteve për angazhimin e diasporës shqiptare në një mënyrë të koordinuar dhe institucionale.

Përkundër hapit pozitiv në krijimin e Ministrisë së Diasporës, është e rëndësishme që anëtarët e Diasporës shqiptare të angazhohen pozitivisht dhe të marrin një rol pro aktiv. Grupi ynë i punës përbëhet nga **18 profesionistë anëtarë të diasporës, që përfaqësojnë tetë (7) rajone nga bota**, të cilët kanë ekspertizë, rrjete dhe përvoja të mira dhe të ndryshme.

METODOLOGJIA

Grupi punues kanë punuar së bashku nga periudha kohore shtator 2017- mars 2018, duke dhënë kontributin e tyre profesional në ndërtimin e këtij planit të veprimit. Puna grupore është ndarë në dy pjesë:

Faza e parë: Gjatë fazës hyrëse, u arrit pajtimit me objektivat e grupit. Disa ide u shkëmbyen gjatë takimit të parë virtual dhe disa anëtarë u angazhuan përmes e-mailit.

Faza e dytë: Gjatë kësaj kohe, është zhvilluar takimi i dytë virtual, planifikimi i planit të veprimit dhe shkëmbimi i ideve si dhe sugjerimeve shtesë në formësimin/kompletimin e planit të veprimit. Në këtë fazë, është ndarë edhe pyetësori me anëtarët e grupit dhe rrjetet e tyre që përgatitë edhe me mbështetje të zyrës qendrore të GERMIN-it.

Faza e tretë: Plani i Veprimit u hartua në konsultim me të gjithë anëtarët e grupit; dhe u përfundua më 05 Prill 2018, si dhe u bën përgatitjet për ta prezantuar në Konferencën e Diasporës 17-20 maj 2018.

Lulzim Syla	NRW, Gjermani, Ellen Group – Kryesues i grupit punues
Drita Llolla Administrativo-Territoriale	Ulqin, Mali i Zi, Projekti "STAR", mbështetje për Reformën
Skender Perpepa Construction LTD	Londër, Mbretëria e Bashkuar, Thornhill Shann
Besar Rexhepaj	Bernë, Zvicër, themelues i "Lority"
Vehap Zuka	Bad Durkheim, Gjermani, Continentale
Ingrid Mlera	Heidelbergut, Gjermani, sipërmarrëse
Alban Nevzati	Binz, Zvicër, UBS – Investment Baking Company
Rita Hoxha	Romë, Itali, Movimento Elle



DIALOGU I STRUKTURUAR PËR TË
DREJTAT E DIASPORËS

Nora Zhilivoda,

Prishtinë, Kosovë

Dhurata Hoti

Londër, Mbretëria e Bashkuar, W Diamond Group

Naim Kadishani

Toflund, Danimarkë, Tembo Construction

Fran Nikollbibaj

New York, ShBA, Financieri LLC

Niman Blakaj

New York, ShBA, Delta Properties USA, Inc

Thodhori Miho

Selanik, Greqi, Progresi Albanian Organization

DRAFT